

NE EMER TE POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjiilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit Hasan Sadiku, me proqesmbajtësen Mimoza Mehmeti, në lëndën penale kundër të akuzuarit Sh.P., nga Gjermania, për shkak të veprës penale Sulm ndaj personit zyrtar gjate kryerjes se detyrave zyrtare nga neni 410 paragrafi 1 i KPRK-se, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Gjiilan, PP.nr.1414/2016, të datës 04.08.2016, të cilën e ka përfaqësuar prokurori i shtetit Shefik Mehmeti, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e prokurorit të shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. K. S. më 11.08.2016 shpalli publikisht këtë,

A K T G J Y K I M

I pandehuri **Sh.P.**, pa pseudonim dhe emër të rrejtshëm, nga i ati Xh. , dhe e ëma Z., mbiemri i vajzërisë H., i lindur më, ne fshatin ..., Komuna e Prishtinës, tani me vendbanim te përhershëm në Republika e Gjermanisë, ka të kryer shkollën e mesme teknike te ndërtimtarisë, me profesion kuzhinier, i punësuar në Gjermani, i gjendjes se mesme ekonomike, i martuar, prindi 6 fëmijëve, shtetas i Republikës se Gjermanisë, deri me tani i padënuar dhe nuk zhvillohet ndonjë procedure tjetër penale ndaj tij, ne paraburgim prej 30.07.2016 deri më 11.08. 2016..

ë s h t ë f a j t o r

Sepse më 30.07.2016, rreth orës 11.00 minuta ne fshatin ..., Komuna e Novobërdës i akuzuari Sh.P., e sulmon personin zyrtar gjatë kryerjes se detyrës zyrtare-policen tani të dëmtuarën S.J, ne ate menyre qe përderisa njësia e policisë ne përbërje të , S.J, B.B,J.S dhe S.J, sipas urdhëresës të eprorit të tyre kishin dalë për të bërë sigurimin në vendin e ngjarjes ku gjeometri bënte matjen dhe përcaktimin e kufijve sipas kërkesës se palës N.B, dhe në momentin kur policja tani e dëmtuara me telefon celular fillon të fotografoj vendin ku duhet te vendosen kufijtë e pronës, i pandehuri me te vërejtur këtë veprim të S. , i njëjti nga një largësi prej 20 metra, i vërsulet për ta sulmuar policen S.J., dhe me këtë rast me shpejtësi intervenojnë dy policët prezentë B.B, dhe J.S., i dalin përpara dhe e pengojnë të pandehurin, ashtu që polici J.J. e kapë për krahu dhe e largon nga S., ndërsa i pandehuri me atë rast i drejtohet të dëmtuarës-policës, duke kërkuar që të ia jep telefonin celular dhe duke i thënë me fjalët “pse po më fotografon, kam me ta shti telefonin ne goje”, nga situata e krijuar për asistencë në vendin e ngjarjes arrin njësia e trafikut regjional ne përbërje të F.K, dhe F.J, dhe së bashku me policët prezentë te pandehurin e arrestojnë dhe e shoqërojnë ne stacionin e policisë në Novobërdë, ndërsa gjeometri dhe ankuesja N.B, nga frika largohen nga vendi i ngjarjes pa kryer matjen , në këtë menyre i akuzuari me veprimet e veta ka sulmuar personin zyrtar ne kryerjen e detyrës zyrtare,

Me qka ka kryer veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar gjat kryerjes se detyrave zyrtare nga neni 410 paragrafi 1 i KPRK-së.

andaj gjykata në bazë të nenit 4, 41,45, 46,47, 73, 74,75, dhe 76, të KPRK-së, lidhur me nenin 365 të KPPRK-së, të akuzuarin e

G J Y K O N

Me dënim me burg ne kohëzgjatje prej 120 (njëqind e njetete) ditëve, i cili dënim me burgim i zëvendësohet me dënim me gjobe ashtu qe per nje dite burgim duhet te paguaj nga 20 euro, por ne qofte

se i akuzuari gjobën e tërësishme nuk e paguan menjëherë aktvendimi mbi gjobën e shqiptuar do të i revokohet dhe dënimin me burgim do ta vuaj menjëherë .

E demtuara S.J, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur propozim akuzën , PP.nr.1414/2016 , të datës 04.08.2016, kundër të akuzuarit Sh.P., nga fsh... , Komuna e Prishtines, për shkak të veprës penale Sulm ndaj personit zyrtar gjate kryerjes se detyrave zyrtare nga neni 410 paragrafi 1 i KPRK-se,

Në Shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të mbajtur më 11.08.2016, Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, Shefik Mehmeti, si në shqyrtimin gjyqësor po edhe në fjalën përfundimtare në tërësi ka mbetur pranë propozim akuzës së paraqitur, duke i propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

I akuzuari Sh.P, pas leximit të propozim akuzës nga ana e Prokurorja e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ka deklaruar se e ka kuptuar plotësisht propozim akuzën përkatësisht veprën penale, për të cilën akuzohet. Ndërkaq mbrojtësi i tij av.K.S., nga Gjilani, deklaroi se lidhur me këtë rast edhe atë sipas padisë private, kinse i akuzuari ka kryer veprën penale, Sulm ndaj personit zyrtar gjate kryerjes se detyrave zyrtare nga neni 410 paragrafi 1 i KPRK-se,

Pas shqyrtimit të provave materiale: dëshmisë së të akuzuarit Sh. P., deklaratës së të dëmtuares S.J., si dhe fotodokumentacionin nga vendi i ngjarjes, gjykata gjeti se: te i akuzuari Sh.P., egzistojnë elementet e veprës penale Sulm ndaj personit zyrtar gjate kryerjes se detyrave zyrtare nga neni 410 paragrafi 1 i KPRK-se.

andaj të njëjtin e shpalli fajtor dhe e dënoi me dënim me burg ne kohëzgjatje prej 120 (njëqind e njezete) ditëve, i cili dënim me burgim i zëvendësohet me dënim me gjobë ashtu që për një ditëburgim duhet të paguaj nga 20 euro, por në qoftë se i akuzuari gjobën e tërësishme nuk e paguan menjëherë aktvendimi mbi gjobën e shqiptuar do të i revokohet dhe dënimin me burgim do ta vuaj menjëherë .

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin Sh. P., gjykata pati parasysh rrethanat lehtësuese si dhe ato rënduese, konform nenit 73 të KPRK-së.

Si rrethana lehtësuese për të pandehurin muar parasysh faktin se më pare nuk ka qenë i dënuar per ndonjë vepër tjetër penale, pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit, pendimin se ne te ardhmen nuk do të kryej ndonjë vepër penale. Si rrethana rënduese për të pandehurin gjykata pati parasysh, rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre.

Sipas bindjes së kësaj gjykate caktimi i dënimit me gjobë ndaj të akuzuarit Sh.P., është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit, si dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së.

Gjykata në kuptim të nenit 463 paragrafi 2 të KPRK-së, të dëmtuares S.J. police ne Stacionin e policisë ne Novoberde, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike i udhëzon në kontest civil .

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 450 paragrafi 1 paragrafi 2 nën paragrafi. 2.6 lidhur me nenin 453 parag.1 të KPRK-së.

Me sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitivë të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË NOVOBËDË - Departamenti
Përgjithshëm

P.nr.45/2016, më 11.08.2016.

Bashkpununtori
Sylejman Rexhepi

Gj y q t a r i
Hasan Sadiku

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, në afat
Prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykim.
Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë,
përmes kësaj gjykate.

NE EMER TE POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjiilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit Islam Thaçi me sekretaren juridike Resmije Krasniqi, në lëndën penale kundër të pandehurit Z. J. nga fsh. „për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 252 paragrafi 1 të KPPK-së , sipas propozim akuzës së Prokurorisë Komunale në Gjiilan, (PK), PP.nr.1683/2011, të datës 04.08.2016 të cilën e përfaqësonte prokurori Ismet Ukishini, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më 12.03.2014 shpalli publikisht , dhe të njëjtën ditë hartoi këtë,

A K T G J Y K I M

I pandehuri **Z. J.**, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati Gj... dhe e ëma.. .., mbiemri i vajzërisë, i lindur më në fsh. , ku edhe jeton, Komuna e Novobërdes, sërb, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i një fëmije, polic, ka të kryer shkollës e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa dënuar deri më tani, për vepër penale , nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale,

konform nenit 364 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPPK-së ,

LIROHET NGA AKUZA

Sepse :

Prej datës së pavërtetuar e gjer më datën 21.02.2011, në kohë të pacaktuar, në shtëpinë e saj në fsh. ... , me qëllim që vetit apo tjetrit t` i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, nga rrjeti i të damtuares, distribuimi në ..., ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike, është koknstatuar se ; njehsori është pa bllomba shtetërore, nga ana e jashtme njehsori dëmtime tjera nuk ka, numruesi i njehsorit i manipuluar, ka gjurmë të gërvishjes së numrave në numratore. Shifra e dyt me numër 0.9, shifra e tretë, me numër 1.2, shifra e katërt me numër 2.3, shifra e pestë me numër 6.7.8 në T1, shifra e katërt, dhëmbëzoret me numër 0.1.2, shifra e pestë, dhëmbëzoret me numër 9.0 në T2, duke pamundësuar regjistrimin e energjisë elektrike të shpenzuar, e që të damtuaren, e ka dëmtuar në shumë prej 149.64 € .

me çka kishte për të kryer veprën penale, vjedhje nga neni 252 paragrafi 1 të KPPK-së,

E dëmtuara – ..., tani ..., për realizimin e kërkesës pasuroro- juridike, udhëzohet në kontest civil.

andaj gjykata në bazë të nenit 4, 41, 46, 73, 74, 75 të KPRK-së, lidhur me nenin 365 të KPPRK-së, të pandehurin e

g j y k o n

Me dënim gjobë (në të holla) në shumë prej 250.-€(dyqindë e pesdhjetë) euro, të cilën shumë i pandehuri ka për ta arkëtuar, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgu, ashtu që për çdo 20 € do t'i llogaritet nga një ditë burg.

I pandehuri detyrohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kërcënim përmbarimi.

Detyrohet i pandehuri që të dëmtuares ..., tani ..., t`ia bëjë kompensimin e dëmit në shumë prej 149.64 €.

A r s y e t i m

Prokuroria Komunale në Gjilan, ka paraqitur propozim akuzën , PP. 1683 /2011 , të datës 27.07.2011, kundër të pandehurit Z. J. nga fsh. , për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 252 paragrafi 1 të KPPK-së, si dhe kërkesën për dhënjen e urdhërit ndëshkimor dënim me gjobë.

Gjykata komunale në Gjilan me Aktgjykimin nr. 978/2011, të datës 11.04.2012, e ka pranuar kërkesën për dhënjen e urdhërit ndëshkimor, duke e shpallur fajtor të pandehurin dhe të njëjtin e ka dënuar me dënim në gjobë në të holla në shumën prej 150 €. I pandehuri në afatin ligjor ndaj Aktgjykimit me numër si më lartë, ka paraqitur kundërshtim.

Në Shqyrtimi gjyqësor dhe publik, të mbajtur më 10.03.2014, Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, Ismet Ukshini, si në shqyrtimin gjyqësor po edhe në fjalën përfundimtare në tërësi ka mbetur pranë propozim akuzës së paraqitur, duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

I pandehuri Z.J.,pas leximit të propozim akuzës nga ana e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, ka deklaruar se e ka kuptuar plotësisht propozim

akuzën përkatësisht veprën penale, për të cilën akuzohet, por nuk e ka pranuar fajësinë për veprën me të cilën ngarkohet.

Për vërtetimin e gjendjes faktike Gjykata ka ftuar dëshmitarët, punëtorët etë cilët në seancën e shqyrtimit gjyqësor kanë deklaruar më sa vijon:

1. Dëshmitari, ka theksuar faktin që unë edhe më herët, por edhe tani punojë në cilësinë e kontrollorit të njëhisorit elektrik, kështu që detyrat i marim nga eprori për vendin e caktuar dhe lokalitetin të cilin e mbulojm. Kështu që njëhisorët i ndërrojm në bazë të dëmtimeve të cilat i konstatojm ne, mirëpo, pastaj të gjithë njëhisorët elektrik të ndërruar prej konsumatorëve i dërgojmë në Qendrën e Kalibrimit në Prishtinë. Me qëllim të verifikimit, përkatësisht të konstatimit se njëhisorët e dyshuar a janë të manipuluar apo jo . Në rastin konkretë njëhisor elektrik i Z.J. është dërguar në në Prishtinë dhe në bazë të raportit të kthyer nga Organi kompetent është konstatuar se njëhisor ka qenë pa bllomba shtetërore, pas dëmtimit nga ana e jashtme, por në brendësi njëhisor elektrik është manipuluar me shifrat e numratorit të cilat gjenden ne te. Në bazë të këtyre manipulimeve të konstatuara nga si që shihen edhe në shkresat e lëndës, është bërë shfrytëzimi i energjisë elektrike në mënyrë të paautorizuar duke manipuluar me shifrat e njëhisorit të kthyer prapa në mënyrë mekanike, e që këto ndërhyrje janë bërë në bazë të gërvishjeve dhe dëmtimeve të bëra në numrator.

Pasi që kemi pranuar Raportin nga për manipulimet në njëhisorin e konsumatorit Z.J., kemi dalur në shtëpinë, në vendin e ngjarjes, përkatësisht në shtëpinë e tij dhe kemi bërë verifikimin e paisjeve elektrike, në bazë të cilave kemi konstatuar energjinë elektrike të shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar gjegjësisht shkaktimin e dëmit. Edhe dëshmitari, punëtor i ..., tani , ka deklaruar se ekipet e ndërrimit të.... –, e kanë bërë ndërrimin e njëhisorit elektrik të konsumatorit Z.J. , për shkak se bllombat e shtetit njëhisor nuk i ka pasur. Andaj nga kjo gjendje e verifikuar në teren kemi dyshuar në njëhisorin elektrik dhe për këtë arsye atë e kemi dërguar në për verifikim në Prishtinë. Pastaj është kthyer procesverbali në të cilën janë vërtetuar dyshimet tona lidhur me pamundësinë e njëhisorit elektrik, pas procesverbalit nga ana e qendrës kompetente është konstatuar se njëhisor është i hapur dhe numrat janë kthyer prapa, me qëllim që kilovatët e energjisë së shpenzuar të mos regjistrohen .

Ndërsa llogaritja e shfrytëzimit të energjisë në mënyrë të paautorizuar nga ana e konsumatorit është bërë në bazë të regjistrimit të paisjeve të amvisnisë për periudhën gjashtë mujore është bërë llogaritja e dëmit të shkaktuar. Në vazhdim të seancës së shqyrtimit gjyqësor me që nga ana e prokurorisë së shtetit është bërë gabim teknik sa i përket datës së shënuar në aktin akuzues, në rreshtin e parë të shënuar 21.02.2011 gabimisht, kështu që prokurori i shtetit Ismet Ukshini, bënë propozimin duke kërkuar që data e 21.02.2011, duhet të fshij dhe në vend të saj duhet të jetë 13.01.2011.

Prokurori i shtetit Ismet Ukshini, në fjalën e vet përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë pretendimeve të theksuara në aktin akuzues si dhe propozimeve që i përmban e njëjta, ndërkaq sa i përket fajësisë që të pandehurit deklarën faktin se gjatë shqyrtimit të sotëm u vërtetua me provat materiale edhe ate dëgjimin e dëshmitarëve si dhe shkresave tjera të lëndës, në bazë të së cilave është vërtetuar se nga i pandehuri është bërë shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike, fakt ky i vërtetuar edhe nga raporti i në Prishtinë, në të cilën është vërejtur kjo se i pandehuri ka manipuluar mekanikisht me numër e njehsorit të energjisë elektrike edhe ate duke i kthyer prapa. Duke pasur parasysh këtë gjendje faktike të vërtetuar i propozon gjykatës që të njëjtin ta gjykojë në bazë të ligjit, ndërsa me rastin e përcaktimit të dënimit të ketë parasysh gjykata të gjitha rrethanat si ato lehtësuese dhe rënduese.

I pandehuri Z. J., në fjalën e vet përfundimtare deklarën se manipulimin e njësorit unë nuk e kam bërë edhe ate me përgjegjësi të plotë theksoj faktin se këtë gjendje e kam trishiguar nga babai im, kështu që nuk e konsideroj vehten fajtor .

Pas shtjellimit të provave materiale: procesverbalit me nr. 4054, të datës 25.02.2011, të hartuar nga,- sektori, procesverbalit të datës 23.03.2011, me shifrën e konsumatorit 14272, faturës DGL11PP02569 të datës 28.04.2011, si dhe fotot e njehsorit nga vendi i ngjarjes, si dhe dëgjimit të dëshmitarëve , gjykata gjeti se: vepra penale vjedhje e përcaktuar nga neni 252 parag. 1 të KPK-së, është shkaktuar edhe ate në bazë të konstatimit nga në Prishtinë, në njësorin e energjisë elektrike me nr. 47445760, me shifër të konsumatorit 14272, e regjistruar në emër të konsumatorit Gj. J., babai i të pandehurit Z. J., prandaj në këtë çështje penalo - juridike nuk është kontestuese kryerja e veprës penale ashtu si që është përshkruar në dispozitiv të aktit akuzues të prokurorisë së shtetit, por kontestuese, por është kontestues fakti sepse nuk mund të shpallet fajtor dhe përgjegjës penalisht Z.J, nga se i njëjti si në fillim, por edhe në fjalën e vet përfundimtare gjatë mbrojtjes ka deklaruar se gjendjen e njësorit elektrik e kam trashëguar nga babai, andaj gjykata erdhi në përfundim se vepra e shkaktuar penale nga babai i tij, i cili tani është i vdekur sipas deklaratës së djalit të tij nuk mund të i ngarkohet të pandehurit Z.J Pasi që gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike në pajtim me nenin 364 parag. 1 nën parag. 1.3 të pandehurin e liroi nga akuza sepse, nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet.

Pala e dëmtuar –, tani , për realizimin e kërkesës pasuroro – juridike, përkatësisht kompenzimin e dëmit udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e Procedurës penale bien në barrë të buxhetit të kësaj gjykate.

Gjykata në kuptim të nenit 463 paragrafi 2 të KPPRK-së, të dëmtuarin për realizimin e kërkesës pasuroro juridike e udhëzon në kontest civil .

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 450 paragrafi 1 paragrafi 2 nën paragrafi. 2.6 lidhur me nenin 453 parag.1 të KPPRK-së.

Me sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NOVOBËDË - Departamenti
Përgjithshëm.

P.nr. 94 / 2013, më 12.03.2014.

Sekretarja juridike
Resmije Krasniqi

Gj y q t a r i
Islam Thaçi,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, në afat Prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykim. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.